

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7932  
E shtunë, 16 nëntor 2024  
Çmimi 0.50

## Osmani: Taktikat e Serbisë nuk e ndryshojnë realitetin e pakthyeshem të Kosovës



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# DNV-ja: KA TENDENCË TË QEVERISË PËR TË NDËRHYRË NË PROCESIN ZGJEDHOR

FAQE 4-5



Koalicioni Demokracia në Veprim (DnV) ka vlerësuar se ministria që drejtohet nga Donika Gërvalla ka tentuar të ndërhyjë në procesin zgjedhor, duke kërkuar hapjen e qendrave të votimit në vende të

tjera. Përfaqësuesi i DnV-së, Eugen Cakolli, ka thënë se një tendencë e tillë është e paligjshme, pasi KQZ-ja është institucioni i vetëm që ka autoritetin për të organizuar dhe administruar zgjedhjet. Po ashtu, ai

ka theksuar se në mungesë të rregullimit ligjor, partitë politike kanë filluar të zhvillojnë aktivitete të para fushatës në mënyrë të shtuar, duke përdorur njëkohësisht platformat digjitale

## ANËTARËT E KOMISIONIT HETIMOR DORËZOJNË DOSJE NË PROKURORINË SPECIALE PËR HETIMIN E 'SHKELJEVE NË MPJD'

F. 3



## HOXHAJ TAKON DELEGACIONIN BRITANIK, KËRKON MBËSHTETJE PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË NATO

F. 5



**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## OPINION

### AS GRENELLIN NUK PO E TUNDON ALBIN KURTI, LËRE MË TRAMPIN

F. 6

Shkruan:  
Behxhet Sh. SHALA  
- BAJGORA



## AKTUALE



### TRUMPI SHPËRBLËN ALEATËT BESNIKË ME ROLE KYÇE

F. 2

### PASTRIMI ETNIK NË INSTITUCIONE, BDI-ja: SHQIPTARËT NËN SULMIN E QEVERISË PA LEGJITIMITET

F. 7

### KQZ-ja THOTË SE DO TË LEHTËSOHET VOTIMI JASHTË KOSOVËS ME HAPJEN E KUTIVE POSTARE

F. 7

## EKONOMI



### BANKA EKONOMIKE INAUGURON DEGËN E SAJ NË MITROVICËN E VERIUT

F. 8

### BQK-ja SHËNON 25-VJETORIN E THEMELIMIT

F. 8

## SPORT



### THIRRJET RACISTE NDËRPRENË NDESHJEN RUMANI - KOSOVË

F. 10

ANALIZË

# Trumpi shpërblen aleatët besnikë me role kyçe

WASHINGTON, 15 NËNTOR - Presidenti i zgjedhur i ShBA-së, Donald Trump, është duke përzgjedhur mbështetësit dhe besnikët e tij më të fortë për postet kryesore. Personat e përzgjedhur nga ai nxjerrin në pah agjendën e tij për politikën e brendshme dhe të jashtme. Presidenti i sapozgjedhur i ShBA-së, Donald Trump, vazhdon t'i plotësojë postet kyçe në administratën e tij të dytë. Emërimet e reja përfshijnë ambasadorin e ShBA-së në Izrael dhe një të dërguar special për Lindjen e Mesme. Udhëheqësi republikan e ka vënë theksin te mbështetësit dhe aleatët e ngushtë të tij gjatë fushatës elektorale për mandatin e dytë presidencial.

## Musk, Ramaswamy për ta mbikëqyrur efikasitetin e qeverisë

Trumpi ka njoftuar të martën se miliarderi Elon Musk do të drejtojë një "Departament të Efikasitetit të Qeverisë (DOGE)" së re në ShBA, i ngarkuar me uljen e burokracisë federale, së bashku me ish-kandidatin presidencial të GOP, Vivek Ramaswamy. Akronimi "DOGE" është një referencë për kriptovalutën Dogecoin, e preferuara e Muskut. Gjatë zgjedhjeve, Musku ka shpenzuar mbi 100 milionë dollarë duke e promovuar veten si një aleat kyç të Trumpit. Musku ka bërë fushatë për Trumpin në platformën "X" si pronar i kësaj platforme të rrjeteve sociale. "Së bashku, këta dy amerikanë të mrekullueshëm do t'i hapin rrugën administratës sime për ta ulur burokracinë qeveritare, për t'i thjeshtuar rregulloret e tepërta, për t'i shkurtuar shpenzimet e kota dhe për t'i ristrukturuar Agjencitë Federale", ka thënë Trumpi në një deklaratë. Sipas deklaratës, Musku dhe Ramaswamy do të punojnë nga jashtë qeverisë për t'i ofruar Shtëpisë së Bardhë "këshilla dhe udhëzime".

## Ish-shefi i inteligjencës në krye të CIA-s

Donald Trump e ka emëruar John Ratcliffe për ta drejtuar CIA-n. Ratcliffe, një ish-kongresist republikan nga Teksasi, ka drejtuar Drejtorinë e Inteligjencës Kombëtare (DNI) në muajt e fundit të mandatit të parë të Trumpit. "Mezi pres që John të jetë personi i parë që do



të shërbejë në të dyja pozicionet më të larta të Inteligjencës së Kombit", ka thënë Trumpi. Ai e ka quajtur Ratcliffe një "luftëtar të patrembur për të drejtat kushtetuese të të gjithë amerikanëve".

## Një konservator i vendosur emërohet ambasador në Izrael

Ish-governatori i Arkansas, Mike Huckabee, një nga zërat më konservatorë të partisë republikane, është emëruar ambasador i ardhshëm i ShBA-së në Izrael. Huckabee, një konservator i vendosur evangelist, është i njohur për mbështetjen e tij për Izraelin. Ai ka shprehur mbështetjen e tij për vendbanimet në Bregun Perëndimor, të cilat konsiderohen të paligjshme sipas ligjit ndërkombëtar. Kjo vjen pasi presidenti i sapozgjedhur Donald Trump ka premtuar se do ta përafrojë politikën e jashtme të ShBA-së më afër interesave të Izraelit. Në një deklaratë në lidhje me nominimin, Trumpi ka thënë se Huckabee "do të punojë pa u lodhur për ta sjellë paqen në Lindjen e Mesme".

## Kush janë sekretarët e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare

Trumpi ka emëruar veteranin e

ushtresë dhe prezantuesin e "Fox News", Pete Hegseth, si sekretarin e tij të Mbrojtjes, duke e lavdëruar atë si "të ashpër, të zgjuar dhe një besimtar i vërtetë në shprehjen "Amerika e Para". "Me Pete në krye, armiq të Amerikës janë në dijeni - Ushtria jonë do të jetë sërish e madhe dhe Amerika nuk do të tërhiqet kurrë," tha ai në një deklaratë. Më herët, Hegseth ka shprehur përbuzje për politikën "woke" në Pentagon dhe ka thënë se ishte larguar nga ushtria në vitin 2021 pasi është konsideruar ekstremist. Gjithashtu, Trumpi ka emëruar guvernatoren e Dakotës së Jugut, Kristi Noem, sekretare të Sigurisë Kombëtare. Ai ka theksuar se ajo ishte guvernatorja e parë që vendosi trupat e Gardës Kombëtare për ta ndihmuar Teksasin t'i luftojë kalimet ilegale të kufirit.

## Partneri i golfit emërohet i dërguar për Lindjen e Mesme

Si zgjedhja e tij për një të dërguar të posaçëm në Lindjen e Mesme, Trumpi ka emëruar mikun e tij të vjetër dhe partnerin e golfit, Steven Witkoff. Witkoff, një investitor në pasuritë e paluajtshme në Florida, është aktualisht kryetar i komitetit inauguroes të Trumpit. "Steve do të jetë një zë i paepur për paqen dhe do të na bëjë të gjithëve krenarë", ka

thënë Trumpi në mediet sociale.

## "Një zë i fortë për kombin dhe luftëtar i guximshëm i kundërshtarëve"

Marco Rubio, senator nga Florida, do të jetë sekretar i Shtetit (ministër i Jashtëm) në kabinetin e Donald Trumpit. "Ai do të jetë një zë i fortë për kombin tonë, një mik i vërtetë i aleatëve tanë dhe një luftëtar i guximshëm i kundërshtarëve tanë që nuk do të tërhiqet kurrë", ka thënë presidenti i ardhshëm republikan duke shpallur përzgjedhjen e tij për një nga postet më të rëndësishme.

## Ambasadorja e ShBA-së në OKB

Kongresistja republikane, Elise Stefanik, do të jetë ambasadorja e ShBA-së në OKB. Stefanik është "luftëtare tepër e fortë, e ashpër dhe e zgjuar" për politikën America First, ka thënë Trumpi, sipas një informacioni të "New York Post".

## "Cari kufitar"

Tom Homan do të jetë "cari kufitar" i ri, ka njoftuar Trumpi në rrjetin e tij social "Truth". Kjo do të thotë se Homan do të jetë përgjegjës për sigurinë kufitare dhe riatdhesimin e

refugjatëve. Përveç monitorimit të kufijve jugorë dhe veriorë, si dhe sigurisë detare dhe ajrore, Homan do të jetë "përgjegjës për kthimin me detyrim të të gjithë emigrantëve të paligjshëm në vendin e tyre të origjinës". Homan është "avokat i palëkundur për kontrollin e kufijve" dhe askush nuk është "më i mirë për mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufijve tanë", tha Trumpi duke shpjeguar vendimin e tij.

Trumpi ishte mbështetur te Homan që në mandatin e parë të tij: Homan ishte atëherë për një vit e gjysmë kreu i autoritetit të imigracionit ICE. Ai u konsiderua si mbrojtës i vendimit të diskutueshëm për të ndarë fëmijët e emigrantëve të parregullt nga prindërit e tyre. Pas kësaj, ndonjëherë u deshën vite për të ribashkuar familjet. Homan - dhe Trump - më vonë thanë se masa kishte synuar të shërbente si frikësim, në mënyrë që familjet as të mos niseshin për në ShBA.

## Deputeti i Nju-Jorkut do të jetë shefe e Autoritetit për Mjedisin në ShBA

Donald Trump, ish-deputetin republikan Lee Zeldin, do ta emërojë drejtor të Autoritetit të ShBA-së për Mjedisin, EPA. Zeldin parashikohet se mund të shfuqizojë dhjetëra norma për mjedisin. Presidenti i ardhshëm Trump deklaroi se Zeldin "do ta shpalojë fuqinë e ekonomisë amerikane" duke ndërmarrë "derregullim të menjëhershëm".

Njëkohësisht Trumpi ka deklaruar se Zeldin "do t'i respektojë standardet më të larta të mjedisit, duke përfshirë edhe ajrin dhe ujën më të pastër në planet". 44-vjeçari Zeldin është një mbështetës besnik i Trumpit dhe pas humbjes së zgjedhjeve më 2020 ai ka votuar në Kongres kundër njohjes së rezultatit të zgjedhjeve. Në platformën "X" ai ka shkruar se është një "nder" t'i përkasësh kabinetit të Trumpit. Ai ka premtuar "ta rikthejë dominancën e ShBA-së në fushën e energjisë, ta rigjallërojë industrinë e automobilave, për t'i rikthyer vendet e punës amerikanëve dhe për ta bërë ShBA-në kryesuese në fushën e inteligjencës artificiale" e, njëkohësisht, për ta "mbrojtur qasjen tek ajri dhe uji i pastër". /DW

# DnV-ja: Ka tendencë të qeverisë për të ndërhyrë në procesin zgjedhor

Koalicioni Demokracia në Veprim (DnV) ka vlerësuar se ministria që drejtohet nga Donika Gërvalla ka tentuar të ndërhyjë në procesin zgjedhor, duke kërkuar hapjen e qendrave të votimit në vende të tjera. Përfaqësuesi i DnV-së, Eugen Cakolli, ka thënë se një tendencë e tillë është e paligjshme, pasi KQZ-ja është institucioni i vetëm që ka autoritetin për të organizuar dhe administruar zgjedhjet. Po ashtu, ai ka theksuar se në mungesë të rregullimit ligjor, partitë politike kanë filluar të zhvillojnë aktivitete të para fushatës në mënyrë të shtuar, duke përdorur njëkohësisht platformat digjitale



PRISHTINË, 15 NËNTOR - Janë bërë më shumë se tre muaj qëkur presidentja Vjosa Osmani ka shpallur datën e zgjedhjeve parlamentare për 9 shkurt 2025. Koalicioni Demokracia në Veprim (DnV) të premtën ka mbajtur një konferencë për medie, në të cilën ka ofruar një vlerësim të periudhës së para fushatës, ndërhyrjeve të qeverisë Kurti, shfrytëzimin e burimeve publike për qëllime elektorale, si dhe për përgatitjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Eugen Cakolli nga Demokracia në Veprim ka theksuar se në mungesë të rregullimit ligjor, partitë politike kanë filluar të zhvillojnë aktivitete të para fushatës në mënyrë të shtuar, duke përdorur platformat digjitale. "Lëvizja Vetëvendosje, si parti në

pushtet, ka zgjedhur t'i orientojë aktivitetet jashtë vendit. Ndonëse edhe partitë opozitare kanë organizuar disa takime me qytetarë jashtë vendit, ato janë fokusuar më shumë në aktivitete brenda Kosovës, për hartimin e programit, publikimin e kandidatëve dhe takimeve të tjera të targetuara. Për më tepër, ka pasur një rritje të sponsorizimeve të postimeve në platformat digjitale nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me mijëra euro të shpenzuara deri më tani", ka thënë Cakolli.

Sipas tij, një nga problematikat më të mëdha të para fushatës së deritanishme është përdorimi i burimeve publike për qëllime

elektorale dhe ndërhyrjet e qeverisë në procesin zgjedhor. "Kjo përfshin veprime që dëmtojnë barazinë e garës zgjedhore dhe mund të ndikojnë në përcaktimin e votuesve, duke krijuar një garë të pabarabartë. Ndër to, masat financiare (rritja e pensioneve, pagës minimale dhe pagave në sektorin publik) të miratuara nga qeveria, që pritet të hyjnë në fuqi pak kohë para zgjedhjeve, shpërfaqin një model të rrezikshëm të përpjekjes për t'i ndikuar votuesit nëpërmjet fondeve publike", ka thënë ai.

Më tutje, Cakolli ka ngritur një tjetër shqetësim të DnV-së, i cili ndërlidhet me procesin e votimit jashtë vendit. Ai ka thënë se ministria që drejtohet nga Donika Gërvalla ka tentuar të ndërhyjë në

procesin zgjedhor, duke kërkuar hapjen e qendrave të votimit në shtete të tjera. Në këtë kontekst, ai ka thënë se një tendencë e tillë është e jashtëligjshme. "Deri tani janë aprovuar rreth 15 000 aplikime për votim jashtë vendit, ku dy të tretat e këtyre aplikimeve janë për votim me postë në misionet diplomatike të Kosovës. Megjithatë, DnV vëren se Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës ka tentuar të ndërhyjë në këtë proces duke kërkuar hapjen e qendrave të votimit në vende të tjera, gjë që është e paligjshme, pasi KQZ-ja është institucioni i vetëm që ka autoritetin për t'i organizuar dhe administruar zgjedhjet. Në anën tjetër, DnV vëren se shumë prej listave të publikuara të kandidatëve të subjekteve politike, përfshijnë kandidatë më të rinj dhe përfshirja e

grave është rritur në mënyrë të dukshme. Megjithatë, u potencua që partia në pushtet është e vetmja që qëndron e mbyllur për publikun sa i përket finalizimit apo publikimit të listës së kandidatëve", ka thënë Cakolli.

Sa i përket administrimit të zgjedhjeve, Cakolli ka thënë se KQZ-ja ka zhvilluar rreth 20 mbledhje, ku përgjithësisht ka mbizotëruar fryma konsensuale e vendimmarrjes. DnV vlerëson që KQZ-ja ka bërë përparim të rëndësishëm duke digjitalizuar pjesën më të madhe të operacioneve zgjedhore, si dhe duke iniciuar fushatë proaktive për informim dhe edukim të votuesve. Demokracia në Veprim (DnV) do të jetë e angazhuar në vëzhgimin e të gjitha fazave zgjedhore. Fushata zgjedhore 30-ditore do të monitorohet nga DnV-ja me 38 vëzhgues afatgjatë në të gjitha komunat e Kosovës, ndërsa gjatë ditës së zgjedhjeve, 550 vëzhgues të tjerë afatshkurtër do të angazhohen për ta mbikëqyrë procesin sipas metodologjisë së Numërimit Paralel të Votave, e njohur si PVT.

DnV-ja do ta vëzhgojë edhe numërimin e votave të kandidatëve në qendrat komunale të numërimit. Angazhimi i DnV-së do ta përfshijë, gjithashtu, monitorimin e shpenzimeve të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre në rrjetet sociale.

## Anëtarët e Komisionit Hetimor dorëzojnë dosje në Prokurorinë Speciale për hetimin e "shkeljeve në MPJD"

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Anëtarët e Komisionit Parlamentar Hetimor për menaxhimin e marrëdhënies së punës të anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm dhe zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës kanë dorëzuar të premtën dosjen për hetim në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

Dosjen e kanë dorëzuar deputetët opozitarë, Ariania Musliu-Shoshi dhe Hisen Berisha nga PDK-ja, Vlora Dumoshi nga LDK-ja dhe Time Kadrijaj nga AAK-ja. Në një deklaram për gazetarët, ata kanë thënë se ka pasur "shkelje të shumta" për të cilat kanë kërkuar hetim.

Ariania Musliu-Shoshi ka treguar disa nga këto çështje për të cilat ka thënë se janë bërë shkeljet. "Duke marrë parasysh faktin që janë marrë vendime të jashtëligjshme, që është shkelur Ligji për Shërbimin e Jashtëm, ai për Zyrtarët Publikë, është shkelur Rregullorja e



Brendshme e cila është në kundërshtim me ligjin aktual për shërbim të jashtëm, një ligj më të përditësuar nuk e kemi pasur në Komisionin për Punë të Jashtme dhe as në Kuvend dhe, rrjedhimisht, të gjitha vendimet që janë marrë nga

ministria dhe sekretari permanent i kësaj ministrie, i cili jashtëligjshëm ka marrë vendimet e njëpasnjëshme, kemi ardhur në përfundim që të kemi një Komision Hetimor Parlamentar, i cili do të merret në detaje me të gjitha këto vendime të

jashtëligjshme", ka thënë ajo. Ndërsa deputetja Time Kadrijaj, e pyetur se cilat çështje konkretisht kanë kërkuar të hetohen, ka përmendur emërimin e ambasadorëve. "Ka shkelje të shumta qoftë në emërimin e

ambasadorëve jashtëligjshëm, sepse kur intervistohen ambasadorët në Komision duhet të ketë kuorum dhe për shumicën e ambasadorëve pa qenë në prezencë fizike nuk merret parasysh, ndërsa kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme i ka njoftuar me telefon deputetët se a jeni për këtë përzgjedhje. E kemi ngritur këtë shqetësim. Ka ambasadorë që brenda natës e kanë marrë shtetësinë e Kosovës në mënyrë që të emërohen ambasadorë", ka thënë Kadrijaj. Më tutje, Musliu-Shoshi ka thënë se "pjesë e hetimit kemi kërkuar të jetë edhe mënyra e blerjes së ambasadave tona, mobilimi, po ashtu, edhe forma të tjera që ne vlerësojmë se është bërë keqpërdorimi i buxhetit dhe, së fundmi, edhe të gjitha këto tubime elektorale që po i mban pushteti, kryesisht kryeministri me ministren e Punëve të Jashtme".

## Dorëzohet Ministria e Arsimit, largon nga përdorimi doracakët skandalozë për edukatën seksuale

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Ministria e Arsimit është dorëzuar zyrtarisht. Pas një debati disaditorë, ministria e drejtuar nga Arbërie Nagavci ka vendosur t'i largojë nga përdorimi doracakët

skandalozë për edukatën seksuale. Ky vendim vjen pas shumë reagimeve lidhur me përmbajtjen e këtyre doracakëve. "Po ashtu, njoftojmë

mësimdhënësit dhe prindërit se doracakët do të largohen nga përdorimi dhe nga faqja zyrtare e MASHTI-t deri në përfundim të rishikimit nga komisioni me ekspertë më të mirë në vend dhe të gjitha palët kompetente

që i japin siguri e qartësi këtij procesi. MASHTI është institucioni i vetëm kompetent me autoritetin ligjor për këtë çështje. Në këtë linjë, çdo vendim jokompetent nga institucionet komunale nuk

prodhon asnjë efekt juridik. Së bashku do të bëjmë më të mirën për fëmijët tanë", ka njoftuar MASHTI, duke bërë me dije se do të formojë komision me ekspertë të kualifikuar, të cilët do t'i rishikojnë këta doracakë.



## Liderët në tubime të diskutueshme me diasporën

Partitë politike kanë shtuar fushatën për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, veçanërisht në diasporë. Kryeministri i Kosovës dhe lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka mbajtur disa takime në diasporë, sikurse edhe liderët e opozitës. Përfaqësues të disa partive opozitare dhe njohës të zhvillimeve politike ka thënë se udhëheqësit e qeverisë janë duke i shfrytëzuar ambasadat dhe burimet e shtetit të Kosovës për fushatë elektorale. Analisti Arton Demhasaj ka vlerësuar se fjalimet e zyrtarëve të lartë qeveritarë të Kosovës në këto tubime kanë përmbajtje politike dhe elektorale

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Vetëm në dy javët e para të nëntorit, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, njëherësh udhëheqës i Lëvizjes Vetëvendosje, ka takuar diasporën e Kosovës në shtatë katër shtete të Evropës: Zvicër, Austri, Norvegji dhe Gjermani. Në postimet e bëra në "Facebook", ai ka shkruar se takimet me bashkatdhetarë i ka të shpeshta dhe i falënderon ata për mikpritjen. "Me afër 300 mijë shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në Zvicër, ne jemi shumë krenarë për lidhjet e forta të cilat i kemi ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës", ka shkruar Kurti në njërin prej postimeve më 2 nëntor. Në më pak se tre muaj, Kosova do t'i mbajë zgjedhjet e rregullta parlamentare. Përfaqësues të disa partive opozitare dhe njohës të zhvillimeve politike ka thënë se

udhëheqësit e qeverisë janë duke i shfrytëzuar ambasadat dhe burimet e shtetit të Kosovës për fushatë elektorale. Zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu, ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se disa prej takimeve të tilla, në të cilat ka marrë pjesë edhe ministrja e Jashtme, Donika Gërvalla, janë organizuar nga ambasadat dhe konsullatat e Kosovës në vendet përkatëse, e disa nga vetë Lëvizja Vetëvendosje. Për të parat, ka thënë ai se "njoftimi për organizimin e tyre ka qenë publik dhe ftesa ka qenë e hapur për të gjithë". Gjatë muajit shtator dhe tetor Kurti ka takuar mërgatën edhe në Shtetet e Bashkuara, në Francë dhe në shtatë katër qytete të Gjermanisë. "Organizimet që realizohen nga strukturat partiake, siç ka qenë rasti në Gjermani, muajin e

kaluar, nuk kanë të bëjnë fare me organizimet e ambasadave dhe konsullatave. Në ato raste, për takime të tilla nuk shfrytëzohen objektet e institucioneve tona diplomatike, e as burimet financiare të tyre", ka thënë Kryeziu. Sipas tij, në secilin takim me mërgatën, Kurti ka bërë thirrje për regjistrimin online të saj, në kuadër të regjistrimit të popullsisë në Kosovë, si dhe për regjistrimin për votim nga jashtë në zgjedhjet që po afrohen - "pa asnjë paragjykim për preferencat e tyre". Afati i diasporës së Kosovës për regjistrim skadon më 31 dhjetor, ndërsa për votim nga

jashtë për zgjedhjet e 9 shkurtit mbyllet më 26 dhjetor.

### Akuzat nga opozita

Në tubime me pjesëtarët e mërgatës së Kosovës në Gjermani dhe Itali, gjatë muajit nëntor, ishte edhe Bedri Hamza, kandidat i Partisë Demokratike të Kosovës për kryeministër. "Ne do ta forcojmë dhe institucionalizojmë lidhjen e shtetit me diasporën. Kuvendi do të ketë deputetë që vijnë nga diaspora jonë", ka shkruar Hamza në "Facebook" pasi, siç ka thënë, "tubimit madhështor" në Shtutgart të Gjermanisë. Nga partia e tij nuk i janë

përgjigjur pyetjes së "Radios Evropa e Lirë" se kush i ka financuar tubimet e tyre. Në një postim në "Facebook" më 9 nëntor, sekretarja e përgjithshme e kësaj partie, Vlora Çitaku, ka thënë se qeveria po i përdor ambasadat dhe burimet e shtetit për fushatë elektorale. "Ditëve të fundit, kryeministri i Kosovës dhe ministrja e Punëve të Jashtme po keqpërdorin hapur pushtetin e tyre politik, paratë e taksapaguesve dhe institucionet tona për të kryer fushatë partiake në diasporë", ka thënë Çitaku. Sipas saj, qeveria "po tenton ta kamuflojë agjendën partiake si punë zyrtare qeveritare".



# Hoxhaj takon delegacionin britanik, kërkon mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në NATO

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Nënkrjetari i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka pritur në takim një delegacion të deputetëve nga Britania e Madhe. Hoxhaj ka thënë se ky takim ka shërbyer si një platformë për diskutimin e çështjeve kyçe që lidhen me prioritetet strategjike të Kosovës në rrafshin ndërkombëtar. Hoxhaj ka ritheksuar rëndësinë e anëtarësimin të Kosovës në NATO, duke e konsideruar këtë proces po aq të rëndësishëm sa shpallja e pavarësisë më 2008. Ai ka vënë theks të veçantë në rolin që duhet të luajë Britania në mbështetjen e shtetndërtimit të Kosovës dhe avancimin e saj drejt anëtarësimin në organizata ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara dhe Këshilli i Evropës. “Në një botë të ndryshimit tektonik gjeopolitik, të kërcënimeve të Serbisë dhe

Rusisë në Ballkan, anëtarësimi i Kosovës në NATO është i rëndësishëm së barabartë me pavarësinë e Kosovës më 2008”, ka thënë Hoxhaj. Ndërsa deputetët britanikë kanë riafirmuar mbështetjen e tyre për Kosovën dhe rëndësinë e përforsimit të bashkëpunimit dypalësh, duke theksuar se stabiliteti i rajonit të Ballkanit mbetet një prioritet i lartë për politikën e jashtme britanike. Ky takim vjen në një moment të rëndësishëm për Kosovën, ndërsa ajo synon ta forcojë pozicionin e saj ndërkombëtar dhe të integrohet në strukturat euroatlantike. “Sot pata kënaqësinë të mirëpres një delegacion të deputetëve nga Mbretëria e Bashkuar, të cilët na vizituan në Kuvendin e Kosovës. Në një botë të ndryshimit tektonik gjeopolitik, të kërcënimeve të Serbisë dhe Rusisë në Ballkan, anëtarësimi i Kosovës në NATO është i rëndësishëm së barabartë



me pavarësinë e Kosovës më 2008. Prioriteti më i rëndësishëm i Mbretërisë së Bashkuar, në raport me Kosovën dhe Ballkanin, duhet të jetë përmbyllja e shtetndërtimit të Kosovës, duke

e mbështetur anëtarësimin e Kosovës në çdo organizatë ndërkombëtare, nga OKB deri në Këshill të Evropës, dhe një partneritet më i ngushtë me Mbretërinë e Bashkuar - ish-in këto temat e takimit me

delegacionin e deputetëve britanikë”, ka shkruar Hoxhaj në “Facebook”. Në këtë takim Hoxhaj ka qenë i shoqëruar nga shefi i deputetëve të AAK-së, Besnik Tahiri.

## Osmani: Taktikat e Serbisë nuk e ndryshojnë realitetin e pakthyeshem të Kosovës

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Presidentja Vjosa Osmani ka folur në lidhje me disa masa të ndërmarrja nga Qeveria e Serbisë në lidhje me Republikën e Kosovës. Osmani ka theksuar se Serbia nuk ka asnjë juridiksion mbi Kosovën që nga viti 1999. Ajo ka vlerësuar se këto janë taktika të Serbisë për ta destabilizuar Kosovën. “Serbia nuk ka asnjë juridiksion as gjyqësor e as

territorial mbi Kosovën që nga viti '99. Edhe ende pa u shpallur Kosova e pavarur më 2008, Rezoluta 1244 ia ka marrë çdo lloj juridiksionin në atë kohë Jugosllavisë dhe fillimisht ka vendosur kompetencat në kuadër të pranisë civile dhe ushtarake dhe nga viti 2008 i vetmi shtet që ka juridiksion mbi këtë territor është Republika e Kosovës, e konfirmuar edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Këto janë

tendenca, taktika të Serbisë për ta destabilizuar Kosovën dhe rajonin dhe ajo që dëshmohe me së miri përmes këtyre veprimeve, është që Serbia ende e ka mendësinë e viteve '90, një mendësi që synon t'i destabilizojë shtetet fqinje, megjithatë realiteti është i pakthyeshem dhe i pandryshueshem dhe Serbia nuk do të mund të arrijë asgjë me këtë”, ka thënë Osmani.



Ajo nuk i ka përmendur tubimet e partisë së saj në diasporë. Tubim me mërgatën në Zvicër ka mbajtur edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në fund të shtatorit. Por, sipas Muharrem Nitajt, i cili drejton shtabin zgjedhor të AAK-së, ai është mbuluar financiarisht nga fondi i partisë dhe partia nuk ka kërkuar ndihmë nga ambasada. Nitaj, po ashtu, ka thënë se Kurti dhe Gërvalla, përmes ambasadave të Kosovës, organizojnë tubime me pjesëtarët e mërgatës dhe bëjnë fushatë parazgjedhore. “Nuk ka problem që kryeministri të zhvillojë fushatë, por së paku atë do të duhet ta zhvillojë nën petkun e partisë së vet politike dhe jo t'i shfrytëzojë përfaqësitë diplomatike që i ka Kosova nëpër vende të ndryshme të BE-së ose në ShBA”, ka thënë Nitaj për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas tij, çështjet për të cilat Kurti dhe Gërvalla ka thënë se u kanë bërë thirrje pjesëtarëve të mërgatës nuk janë kompetencë e tyre, por e Agjencisë së Statistikave të Kosovës,

përkatësisht Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Lidhja Demokratike e Kosovës deri më tash nuk ka publikuar ndonjë takim me pjesëtarët e diasporës.

Zyrtarët e saj nuk u janë përgjigjur kërkesave të “Radios Evropa e Lirë” për t'i komentuar takimet e organizuara të liderëve me diasporën.

### A mund të organizojnë e financojnë tubime ambasadat?

Ish-ambasadori i Kosovës në Gjermani, Skënder Xhakaliu, duke u bazuar në përvojën e tij disavjeçare si diplomat, ka shpjeguar për “Radion Evropa e Lirë” se roli primar i ambasadave është përfaqësimi diplomatik i Kosovës në vendet përkatëse ku janë ato. Sipas tij, në kuadër të vizitave diplomatike të krerëve të institucioneve shtetërore në vendet nikoqire, “mund të organizohen edhe takime me bashkatdhetarët, për shkak të informimit të nevojshëm të

tyre”, lidhur me çështje të caktuara. “Jashtë vizitave diplomatike, natyrisht që çdo institucion i qeverisë apo çdo individ i partisë politike ka të drejtë të organizojë tubime, por ato janë tubime jashtë procesit diplomatik”, ka thënë Xhakaliu.

Ai ka shtuar se ndihma që ofron shërbimi diplomatik duhet të jetë vetëm mbi bazën e përfaqësimit diplomatik, ku nuk hyjnë organizimet e tubimeve.

Tubimet e tilla, sipas tij, mund të organizohen nga individë, shoqata apo organizata të ndryshme, të cilat kanë të drejtë të ftojnë përfaqësues institucionesh, liderë të partive etj. “Për çdo organizim që bëhet jashtë përfaqësimit diplomatik, ambasadat dhe shërbimet konsullore nuk kanë obligime financiare”, ka thënë Xhakaliu.

### “Fjalime elektorale” në tubimet me mërgimtarët

Arton Demhasaj, nga

organizata joqeveritare “Çohu” në Prishtinë, ka thënë se takimet e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe zëvendëskryeminstres Donika Gërvalla me pjesëtarët e diasporës së Kosovës në vende të ndryshme evropiane, janë tubime parazgjedhore. Sipas tij, fjalimet e zyrtarëve të lartë qeveritarë të Kosovës në këto tubime kanë përmbajtje politike dhe elektorale. “Fjalimet që i ka publikuar zëvendëskryeministrja dhe kryeministri, thjesht, janë elektorale. Po ashtu, ka pasur raste ku takimi është mbajtur nga kryeministri, lajmërimi ka dalë nga Zyra e Kryeministrit, njëkohësisht edhe nga ana e partisë (Lëvizjes Vetëvendosje). Krejt këto janë të lidhura me njëra-tjetrën”, ka thënë Demhasaj për “Radion Evropa e Lirë”. Ai ka theksuar se, në këtë kontekst, zyrtarët e qeverisë janë duke i keqpërdorur resurset publike për interesa partiake. “Po keqpërdoren resurset publike, sidomos ambasadat, sepse krejt këto

takime po ftohen, po organizohen nga ana e ambasadave të Kosovës me diasporë dhe, pastaj, kryeministri dhe zëvendëskryeministrja po shkojnë dhe po bëjnë fushatë në këto takime”, ka thënë Demhasaj. Diaspora e Kosovës është e përqendruar kryesisht në Gjermani, Zvicër, Austri dhe vende të tjera të Evropës. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit, deri në fund të vitit 2018, ka qenë mbi 850 000. Ndonëse partitë politike në Kosovë kanë nisur takime dhe tubime edhe me qytetarë brenda Kosovës, me rregulloren e KQZ-së periudha e fushatës së zgjedhjeve fillon 30 ditë para ditës së zgjedhjeve. Në rastin konkret, sipas KQZ-së, periudha e fushatës së zgjedhjeve për partitë politike dhe kandidatët e certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet e 9 shkurtit, fillon zyrtarisht më 11 janar, 2025.

# As Grenellin nuk po e tundon Albin Kurti, lëre më Trampin



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**Grenelli është engjëll krahasuar me.....:** Në Amerikë përfunduan zgjedhjet ashtu si pata shkruar në gazetën "Epoka e re", Trampi ishte si Barcelona, Harris si Reali, pra Barcelona e shkërmoqi Realin me rezultat 4 me 1. Ashtu edhe Trampi bëri diferencën me vota elektorale, fitoi votat popullore, e fitoi shumicën në Senat sikur që vetëm 4 vota e ndajnë nga shumica në Dhomën e Përfaqësuesve apo Kongres. Realisht, Kamala Harris, sipas rregullave tona zgjedhore, nuk e kaloi pragun. Sikur Nisma në zgjedhjet e fundit, kurse Trampi i fitoi të gjitha, sikur LV-ja në zgjedhjet e fundit. Forcat politike që deklarohen si të djathta në Kosovë, e që prejardhjen politike por edhe veprimin e kanë të majtë, iu gëzuan fitores së Trampit, kurse Pacolli, nga aeroporti i Marecit, fluturoi në Mar a Lago në Florida për të festuar këtë fitore. Natyrisht, u takua edhe me Ilon Musk për ndonjë investim në të ardhmen. Sigurisht se këtë investim material, profesional dhe intelektual, Pacolli do ta përdorë në zgjedhjet e ardhshme në Kosovë për t'u bërë pjesë e Kuvendit. Nuk kam asnjë dyshim se do të bëhet. Fitores së Trampit i janë gëzuar Sali Berisha dhe Ilir Meta, i pari me shpresë se do të denongratizohet (do i hiqet non grata) dhe Meta se do ta ndërrojë ambientin e banimit, nga 313,

burgu në Tiranë, te hoteli i Lul Morinës apo, për t'u bërë pak më modest dhe popullor, te Gjiri i Lalëzit. Gjasat për këtë janë si të Muços që shkonte pas daive të dashit. Fitorja e Trampit ua ka pasuruar fjalorin fyes ndaj SPAK-ut dhe Xhorxh Sorosit. Nuk do të vepronin kështu po të kurseheshin nga SPAK-u dhe po të merrnin lekë nga plakushi Xhorxh.

**Po në Kosovë, a pati hidhërim apo gëzim:** LV-ja votoi për Harris dhe kundër Trampit. Opozita ishte me Trampin duke shpresuar se do ua heqë qafe Kurtin dhe elitën e tij intelektuale që janë Dimal Basha, Halil Thaçi, Mef Bajçina, Pambuke Kullashki, Cube Drejtësia, Rozafa Majmali, Hajnrullah Çeko, Xhelal Stupci, Artan Dizelli, Ben Hajni dhe të tjerët, numri i të cilëve nuk është i vogël. Në fakt, përbëjnë shumicën absolute. Dimali është si Baba Vanga i LV-së, i parashih gjërat në Amerikë me një saktësi të pabesueshme sikur që parapau se Harris do të fitojë bindshëm në zgjedhjet në.....Kurdistan. I gori Dimal, djali i mirë sa nuk e ka shoqin por se nuk sheh politikisht më larg se hunda. Madje as aq.

**Shpresat e opozitës, te qok... e Grenellit:** Opozita e mendon Grenellin si gogol për Kurtin duke harruar se Trampi prenë dhe

qepë për të gjithë, krejtësisht sipas masës të përcaktuar nga vet ai e jo përmasave trupore të klientelës. Duket se kësaj radhe një Tramp më i pjekur politikisht ka vendosur ta lë Grenellin lakuriq sa i përket fuqisë së ndikimit dhe vendimmarrjes politike. Grenellin eventualisht mund ta përdorë për punë jo shumë apo aspak të pastërta. Kosova duket se nuk paraqet asnjë interes për administratën Tramp 2. Administrata Tramp 2 ka më shumë interes te Serbia, pa asnjë dyshim. Serbia ofron lithium, ka nënshkruar marrëveshje miliarda dollarë për energji me Amerikën, mundëson investime miliarda euro nga Kushner, dhëndër i Trampit, në Serbi, shërben si urë lidhëse me Rusinë, Iranin, Indinë dhe Kinën etj. Kosova nuk ofron asgjë që u përmend më lartë përveç trurit të Dimalit, Mefit, Pambuke Kullashkit, Cube Drejtësisë, Xhelal Stupcejbollit, Rozetës së Himalajeve, Halil Cefalusit, Pecit të Vogël, Donika Shvarcvaldit etj., margaritarë të dijes dhe pionierë të Inteligjencës Artizanale, shkallë më e avancuar se ajo artificiale.

**Po Albini, si dhe sa do të përfitonte nga Grenell:** Nëse dikush realisht do të përfitonte nga faktorizimi i Grenellit, ai, pa asnjë dyshim do të ishte Albin Kurti përmes riviktimizimit.

Herën e parë, Grenell dhe opozita e papërgjegjshme që e rrëzuan në kohën e pandemisë, ia siguruan Kurtit 51 për qind të votave. Albin Kurti e ka çështje të mbijetesës politike, pse jo edhe fizike, konfrontimin me administratën Tramp 2 duke e konsideruar si xhoker pikërisht Riçard Grenellin. Për Albinin, një telefonatë me Trampin apo Rubion do të ishte si një bisedë me Zotin vet, pavarësisht përmbajtjes së bisedës. Për Albinin situata më e rëndë do të bëhej nëse as nuk do të riviktimizohet nga Grenell e as nuk do të telefonohej nga Tramp ose Rubio, do të mbetej në situatë duke pritur Godonë. Mendoj ashtu do të ndodhë. Albinin mund ta forcojë brenda Kosovës kryeneçësia e opozitës së papjekur politike të Kosovës, në vend të shfrytëzohet njëqindmijë penallti që ia mundëson pozita, këta luajnë me karta bluf, në antiamerikanizmin e Albinin dhe me këtë vetëm e rrisin. Albini, në planin ndërkombëtar është i mbaruar, sikur Sholci që iku përlesh. Në planin ndërkombëtar Albini po e luan ruletin rus me Marrëveshjen e Brukselit dhe aneksin e Ohrit, marrëveshje që brutalisht e shkërdhenë pavarësinë e Kosovës dhe sovranitetin policor. Marrëveshje që e defaktorizon Gjykatën Kushtetuese në favor të arbitrazhit. Terr Abazoviqi,

përmes Kishës Ortodokse e ktheu Serbinë në Mal të Zi, Albin Kurti me Marrëveshjen e Brukselit e shndërron Kishën Ortodokse serbe në Kosovë, në shtet brenda shtetit. Serbëve iu siguron autonomi politike dhe territoriale. E përjashton njohjen reciproke. Dhe që puna të bëhet m.t, Albin Kurti më shumë angazhohet për realizimin e kësaj marrëveshjeje, se që ishte angazhuar Ismail Qemali për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë!

I ndihmuar nga "këshilltarët" përfitues, fillojugosllavi i dëshmuar, Veton Surroi dhe mercenari Marc Weller. Dhe nga një "diplomate" skajshmërisht e hendikepuar profesionalisht, Donika Shvarc. Këto duhet të jenë argumente për opozitën e jo "antiamerikanizmi" i Kurtit. Nëse opozita i mirëpërdorë këto argumente, Kurti nuk i fiton as 30 për qind të votave kurse PDK-ja dhe LDK-ja nuk janë nën 24 për qind, AAK - NISMA nën 9 për qind e as Lidhja për Familjen nën 5 për qind. Në këto rrethana LV-ja ka gjasa të mos jetë partia e parë. Nëse opozita i mëshon lahutës duke madhëruar Grenellin apo shpreson se administrata Tramp 2 do të votojë për ta se janë burra të mirë, do ta fitojnë të trashët e Surlës apo, në vend të mishit për zgarë do t'i përdorin daitë e dashit të Muços. Ta shohim! Koha po ecën shpejt!

## Kryeziu: Nagavci do të duhej të jepte dorëheqje pas skandalit me doracakët për edukimin seksual

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, do të duhej të jepte dorëheqje pas skandalit të shpërndarjes së doracakëve për edukimin seksual. Ai ka shkruar në "Facebook" se sjellja e papërgjegjshme e qeverisë dhe ministres së Arsimit jo vetëm që shkel standardet e qeverisjes etike dhe përgjegjësisë publike, por rrezikon të nxisë reagime negative nga qytetarët ndaj edukimit seksual dhe

shëndetit riprodhues. "Në një qeverisje etike dhe me integritet, ministrja Nagavci do të duhej të jepte dorëheqjen pas skandalit dhe gabimeve ne doracaket e hartuar. Sjellja e papërgjegjshme e qeverisë dhe ministres së arsimit jo vetëm që shkel standardet e qeverisjes etike dhe përgjegjësisë publike, por gjithashtu rrezikon të nxisë reagime negative nga qytetarët ndaj edukimit seksual dhe shëndetit riprodhues. Doracakët mund të rishkruhen e të përmirësohen,

por një ministre që nuk mban përgjegjësi për atë që ndodh në dikasterin e saj rrezikon gjithë idenë e edukimit seksual - një lëndë edukative, që sipas të gjitha studimeve në vendet ku praktikohet si lëndë mësimore, ka treguar se të rinjtë bëhen me të informuar dhe me të përgjegjshëm, duke ulur kështu rreziqet që prekin fëmijët nga mungesa e informacionit. Edukimi seksual dhe shëndeti riprodhues nuk është lëndë mësimore për të nxitur e promovuar sjellje të



papërshtatshme të fëmijët, që i mbrojnë nga rreziqet dhe përkundrazi për t'u dhënë keqkuptimet", ka shkruar atyre njohuri dhe informacion Kryeziu.

## Pastrimi etnik në institucione, BDI-ja: Shqiptarët nën sulmin e qeverisë pa legjitimitet

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

SHKUP, 15 NËNTOR - Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) ka dënuar fuqimisht fushatën në vazhdim të diskriminimit etnik dhe "pastrimit institucional" që po vihet në zbatim ndaj administratorëve shtetërorë dhe publikë, punonjësve të policisë dhe atyre shëndetësorë si dhe shërbyesve civilë me përkatësi shqiptare. "Nën maskën e një 'patriotizmi' të rremë dhe të retorikës së 'kthimit të Maqedonisë maqedonasve', po kryhet një përpjekje sistematike për të degraduar dhe marginalizuar profesionistët që i kanë shërbyer këtij shteti me përkushtim dhe profesionalizëm të pakontestueshëm. Punonjësit shqiptarë, të cilët kanë dëshmuar lojalitetin e tyre ndaj institucioneve dhe qytetarëve të këtij vendi, po degradohen



dhe po largohen në mënyrë të padrejtë nga detyrat e tyre", është thënë në reagimin e BDI-së, duke theksuar se kjo fushatë është një sinjal alarmues për një agjendë më të gjerë, që

synon të përmbysë parimet e barazisë dhe harmonisë multietnike, të cilat janë themelet e Marrëveshjes së Ohrit. "Kjo përpjekje e orkestruar nuk është vetëm një

fyerje ndaj shqiptarëve - është një sulm ndaj vetë strukturave të shtetit. Degradimi i profesionistëve në polici, në sektorin e shëndetësisë dhe në institucionet e tjera publike dërgon një mesazh të rrezikshëm: se diskriminimi mund të institucionalizohet. Ne i bëjmë thirrje qeverisë të ndalojë menjëherë këto praktika, të cilat jo vetëm që janë të padrejta, por minojnë edhe stabilitetin dhe kohezionin e vendit tonë", thuhet në reagim. Gjithashtu, BDI-ja i ka bërë apel komunitetit ndërkombëtar t'i ndjekë nga afër këto zhvillime, pasi ato përfaqësojnë një shkelje të parimeve të demokracisë, të drejtave të njeriut dhe barazisë. "Për ata që po orkestrojnë këtë fushatë ndarjeje, ne pyesim: Çfarë mesazhi po përcipen t'i përcillni qytetarëve të këtij vendi? A është ky një mesazh që diversiteti është kërcënim, dhe jo forcë? BDI ka qenë

gjithmonë dhe do të jetë zëri dhe mbrojtësi i barazisë, drejtësisë dhe unitetit. Ne nuk do të qëndrojmë të heshtur përballë përpjekjeve për të zhbërë progresin e arritur ndër vite. Për shërbyesit publikë, policët, mjekët dhe administratorët që janë në shënjestër, dijeni këtë: Nuk jeni vetëm. BDI qëndron fuqishëm me ju, si gjithmonë. Ne do të sigurojmë që dinjiteti dhe të drejtat tuaja të mbrohen", thuhet në reagimin e BDI-së. Më tutje theksohet se të gjithë duhet të kujtojnë se forca e këtij vendi qëndron në diversitetin dhe përkushtimin e përbashkët për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët. "Diskriminimi dhe ndarja vetëm na dobësojnë. Është detyra jonë kolektive të rezistojmë ndaj këtyre forcave dhe të punojmë së bashku për një shtet dhe shoqëri ku mbizotërojnë barazia dhe respekti reciprok", është theksuar në reagimin e BDI-së.

## KQZ-ja thotë se do të lehtësohet votimi jashtë Kosovës me hapjen e kutive postare

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Të paktën në 22 shtete të ndryshme të botës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka paraparë të hapë nga një kuti postare për qëllime të votimit jashtë Kosovës. Një kërkesë të tillë KQZ-ja do t'ia përcjellë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e cila, sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, do të duhet t'i ndihmojë këtij institucioni për hapjen e kutive postare. Por, përse duhet të hapen kutitë postare në shtete të ndryshme dhe cili është ndikimi i tyre në procesin e votimit jashtë Kosovës? Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë për "Ekonomia Online" se hapja e kutive

postare në shtete të ndryshme është e domosdoshme në aspektin ligjor, ndërsa në aspektin praktik kutitë postare do ta lehtësojnë procesin e votimit jashtë Kosovës. Elezi ka thënë se këto kuti postare do të shërbejnë për ofrimin e mundësisë për votim për shtetasit që regjistrohen suksesshëm për votim jashtë vendit dhe që zgjedhin mënyrën e votimit për ta dërguar fletëvotimin në kutinë postare jashtë Kosovës. Përveç që konsiderohet si një mënyrë e lehtë për të votuar, sipas tij, kjo ka edhe kosto minimale. "Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, gjatë periudhës së aplikimit për t'u regjistruar si votues

jashtë Kosovës, në momentin e regjistrimit votuesit mund të përcaktohen individualisht për mënyrën e votimit. Tri mundësi i ofron ligji: (1) fizikisht në njërin nga përfaqësitë diplomatike të Kosovës (2) duke dërguar fletëvotimin përmes postës në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë dhe (3) duke dërguar fletëvotimin përmes postës në një nga kutitë postare të hapura nga KQZ-ja përmes dhe me ndihmën e përfaqësive diplomatike, jashtë Kosovës. Andaj, vendimi i KQZ-së i shërben ofrimin të mundësisë për votim për shtetasit që regjistrohen suksesshëm dhe që zgjedhin mënyrën e votimit



duke dërguar fletëvotimin në kutinë postare jashtë Kosovës", ka thënë Elezi. Gjithashtu, Elezi ka treguar edhe të dhënat e fundit nga periudha e aplikimit për

regjistrim të votuesve jashtë Kosovës. Sipas të dhënave, numri më i madh i shtetasve të regjistruar është për ta dërguar fletëvotimin në kutinë postare jashtë Kosovës.

## BQK-ja shënon 25-vjetorin e themelimit

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka shënuar 25-vjetorin e themelimit me një konferencë ndërkombëtare të nivelit të lartë me titull: "Ndërtimi i urave përtej kufijve, ndërtimi i ardhmërive: Integrimi në SEPA për gjithëpërfshirje financiare – fuqizimi i rritjes dhe reziliencës".

Në këtë ngjarje ndërkombëtare kanë marrë pjesë udhëheqës të lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), të Grupit të Bankës Botërore (BB), zyrtarë të lartë të institucioneve të vendit dhe ndërkombëtarë, guvernatorë të bankave qendrore të rajonit e të vendeve

evropiane dhe drejtues të institucioneve të tjera financiare. Pjesëmarrësve me një fjalë mirëseardhje i është drejtuar nikoqiri i kësaj konference, Ahmet Ismaili, guvernator i BQK-së.

Të pranishmëve me një fjalim hyrës i është drejtuar edhe Vjosa Osmani Sadriu, presidente e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, këtë konferencë ndërkombëtare të organizuar me rastin e 25-vjetorit të BQK-së përmes një videomesazhi e ka uruar Kristalina Georgieva, drejtoreshë menaxhuese e FMN-së.

Derisa fjalimin kryesor e ka mbajtur, Robert Holzmann,

guvernator i Bankës Kombëtare të Austrisë.

Gjatë kësaj konference janë paraparë të mbahen tri sesione shkencore, me pjesëmarrje të guvernatorit dhe zëvendësguvernatorit të BQK-së, guvernatorëve të rajonit dhe vendeve të BE-së si dhe drejtuesve të lartë të institucioneve financiare ndërkombëtare: integrimi në SEPA, transformimi digjital dhe implikimet për shërbimet financiare, përmirësimi i stabilitetit financiar në peizazhin në ndryshim; dhe ndërmjetësimi financiar brenda sektorit bankar në rajon.

Gjithashtu, është paraqitur



studimi "Pagesat dhe transaksionet pa para të gatshme: Si veprojnë qytetarët në Ballkanin Perëndimor" nga Julia E. Wörtz, nga Banka e

Qendrore e Austrisë. Punimet e kësaj konference janë përmbyllur nga Bashkim Nurboja, kryetar i Bordit të BQK-së.

## MBPZHR-ja dhe GIZ-i, sesion informues rreth skemës së granteve me fermerët pejanë, vlera totale mbi 20 milionë euro


PEJË, 15 NËNTOR - GIZ-i gjerman në Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), kanë mbajtur të premtën sesionet informuese për skemën e granteve 2024-2027 në komunën e Pejës.

Në këtë ngjarje është paraqitur skema e granteve për mbështetje për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor në zonat rurale nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve. Kjo skemë e granteve, e cila është në vlerën e mbi 20 milionë eurove, do të jetë e ndarë në tre lote e që do të jetë për zhvillimin e agro-turizmit, zhvillimit rural dhe ekoturizmit.

Edmond Gashi, udhëheqës i programit për zhvillim ekonomik në GIZ-in gjerman, ka thënë se fokusi i këtij projekti do të jetë zhvillimi rural.

"Ky program do të zbatohet në tërë Kosovën. Regjioni i Pejës do të jetë i përfshirë. Kryesisht fokusi do të jetë në zhvillimin rural përmes tri loteve. Projekti do të zgjasë tri vjet. Thirrja e parë do të ndodhë shumë shpejt. Është çështje e ditës kur do ta shpallim", ka thënë ai.

Ndërsa Shpresim Domi, profesor në Universitetin e Tiranës, duke paraqitur para



ndërmarrësve këtë projekt, ka thënë se qëllimi i projektit është të ofrojë mbështetje financiare dhe ngritje kapacitetesh me synim ngritje të alternativave të të ardhurave në zonat rurale. Ai ka thënë se grupet e synuara të këtij programi janë fermerët, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, grupet e fermerëve dhe individë të ndryshëm.

"Kjo është rrjedhojë e një

marrëveshje të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, marrëveshje në mes të qeverisë gjermane përmes GIZ-it dhe Qeverisë së Kosovës. Qëllimi i këtij programi mbështetës, financiar dhe ngritjesh kapacitetesh njerëzore, është që të ofrojë mbështetje financiare dhe ngritje kapacitetesh me synim ngritje të alternativave të të ardhurave në zonat rurale të të gjitha zonave

të Kosovës, ngritja e mundësive të punësimit. Rritje e numrit të punësimit dhe, për rrjedhojë, një zhvillim socio-ekonomik dhe kulturor të këtyre zonave. Do të ofroj mbështetje financiare ndaj target grupeve ose grupeve të cenuara. Dhe kjo do të shoqërohet me asistencë teknike në dy drejtime. Ndaj atyre që janë të angazhuar në politikbërjen e sektorit

bujqësor. Grupet e synuara janë fermerët, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, grupet e fermerëve dhe individë të ndryshëm që mund të përfitojnë", ka thënë Domi. Ai ka thënë se në lotin 1 shuma e ndihmës është nga 1 500 deri në 5 000 euro. Për lotin 2 shuma e grantit është nga 5 000 deri në 50 mijë euro dhe lot 3 nga 50 mijë deri në 350 mijë euro.

## Banka Ekonomike inauguron degën e saj në Mitrovicën e Veriut

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Banka Ekonomike (BE) ka shënuar një çast të veçantë dhe historik duke inauguruar degën e re në Mitrovicën e Veriut dhe duke zgjeruar edhe më tej rrjetin e saj në të gjithë territorin e Kosovës. Kjo degë e re vjen si rezultat i angazhimit të vazhdueshëm të Bankës Ekonomike për të ofruar shërbime lehtë të qasshme dhe mbështetje financiare për qytetarët dhe



bizneset e kësaj zone. Si një nga institucionet kryesore financiare në vend, aktualisht Banka operon me një rrjet prej 33 njësish bankare, përfshirë 7 degë në qendrat kryesore dhe 26 nëndegë të shpërndara në komunitetet më të vogla, duke u mundësuar qytetarëve qasje të shpejtë dhe të sigurt në shërbimet bankare. Me mbi 150 000 klientë të

regullt, 65 ATM dhe mbi 1 638 POS terminale në të gjithë Kosovën, Banka Ekonomike mbetet një nga institucionet më të besueshme dhe të qasshme për klientët e saj. Hapja e degës në Mitrovicën e Veriut është një hap tjetër drejt misionit të Bankës për të ndihmuar në zhvillimin ekonomik të çdo zone të Kosovës dhe për të krijuar mundësi të reja për klientët e saj.



# Ana e errët e rinisë së përjetshme



“Njerëzit gjithmonë duan diçka të re. Është e pashmangshme. Dhe në të pesëdhjetat, gjithçka ka mbaruar”. Me këto fjalë në *The Substance*, një film i Coralie Fargeat i prezantuar në Festivalin e Filmit në Kanë dhe i publikuar më 30 tetor, producenti televiziv Harvey (Dennis Quaid) ia plas në sy Elisabeth Sparkle (Demi Moore), një ish-yll kinemaje, e cila, pak e shkuar në moshë, përfundon në ekranin e vogël duke bërë mësimë të gjimnastikës në stilin e Jane Fonda.

Gruaja e refuzuar nga shefi i saj që i vlerëson gratë vetëm bazuar në ekuacionin rinia=bukuri, vendos t’i bashkohet një programi që i është propozuar në mënyrë anonime, me emrin si titulli I filmit (*Substanca*) dhe merr në shtëpi një pajisje me shiringa, shishe dhe provëza së bashku me një substancë fosforeshente dhe një sërë rregullash: nëse e injektos atë në vena, ajo do të prodhojë një version më të ri të vetes, por pasi të ketë jetuar shtatë ditë në trupin e saj më të ri, teksa trupi prej të moshuare pushon, do të duhet të kthehen tek origjinali për shtatë ditë të tjera, duke shkaktuar një alternim të përkohshëm që nuk mund të prishet, nën dënimin e efekteve anësore të

tmerrshme.

Kështu pas injektimit, Sue (Margaret Qualley) del nga trupi i Elisabeth, një version i bukur dhe shumë i ri i vetes, e cila shpejt rimerr punën që ajo, tashmë e moshuar, sapo kishte humbur në TV, duke e lënë Harvey-n pa fjalë me sensualitetin e saj. Problemi, megjithatë, për Sue është se mungesa e një jave të tërë dhe vendosja përsëri në trupin e moshuar të Elisabeth në planin afatgjatë, bëhet një problem i vërtetë që i pengon suksesin. Dhe kështu, ajo vendos të zgjasë vigjilencën, duke shkaktuar pasoja të paimagjinueshme.

“Ajo që më pëlqeu në skenarin e Coralie është se i gjithë filmi përqafon perspektivën mashkullore të një gruaje të idealizuar, në të cilën ne vetë kemi besuar dhe të cilës i jemi përshtatur”, shpjegon Demi Moore, e cila në moshën 62-vjeçare dhe pas sukseseve të mëdha me filma të tillë si *Ghost*, *Indecent Proposal* dhe *Private Jane*, që datojnë tridhjetë vjet më parë, është lënë disi mënjane nga Hollywood-i.

“Ajo që është vërtet interesante për filmin”, thotë regjisorja Coralie Fargeat, “është se kur Elisabeth prodhon këtë version më të ri, seksi dhe me sa duket më të mirë të vetes, ajo më në fund merr shansin që i ishte

mohuar, por përsërit edhe një herë të njëjtin model, duke kërkuar miratimin prej mashkullit, dhe në fund e gjen veten duke luftuar vetëm me veten e saj, sepse në fund të fundit këtu duhet të bëjmë ndryshimin e vërtetë, në mënyrën se si sillemi dhe jo se si u shkojmë pas qejfit dhe u përulemi atyre që na shikojnë.”

Fargeat shton: “*The Substance* është një film që flet për mënyrën sesi trupat e femrave janë gjithmonë objekt i shqyrtimit, fantazive dhe kritikave brenda debatit publik dhe se si ne femrat na shtyjnë të mendojmë se nuk kemi zgjidhje tjetër përveç të qenit perfekte, seksi, të qeshura, të holla, të reja dhe të bukura për të pasur vlera në shoqëri. Në dritën e gjithë kësaj, kur mbusha 40 vjeç, mendova se jeta ime do të kishte mbaruar, se askush nuk do të më pëlqente më dhe askush nuk do të më donte apo nuk do u dukeshin interesante. Dhe kështu vendosa të realizoj këtë film për ta trajtuar atë temë. Historia mund të të bëjë të mendosh për “Portretin e Dorian Greit”, por edhe për histori të tjera universale që reflektojnë mbi gjendjen njerëzore, mbi frikën e plakjes, edhe pse këtu ka të bëjë kryesisht me gratë”.

Larg nga të qenit një broshurë

e mërzitshme për këtë temë, filmi ka stilin dhe ngjyrat e ndezura të reklamës magjepsëse dhe nuk kursen as shkrepe detajesh tmerruese, duke filluar nga trupi i Elisabeth, i cili copëtohet në dysh për ta nxjerrë jashtë versionin e saj më të ri.

“E kam menduar që në fillim si një tmerr”, shpjegon Fargeat, “dhe e dija se do të kisha dashur të përdorja më pak efekte dixhitale dhe sa më shumë truke të ishte e mundur, sepse ky ishte një film për trupin, kështu që kishte nevojë të perceptohej materialiteti i mishit: puna për të krijuar një grim që ishte bukur për t’u parë dhe krijuar emocione të forta në publik ishte një kohë e gjatë. Për disa skena Demi duhej t’i nënshtrohej seancave të grimatit që zgjasin deri në shtatë orë, ndërsa për të tjerat në të cilat ajo duhej të shfaqej shumë e hollë, përdorëm një triko, edhe pse puna më e gjatë ishte tek Margaret për finalen e madhe të filmit.”

Në të njëjtën kohë, duke qenë se flitet për trupa, ato të bukurat e Demi Moore dhe Margaret Qualley (vajza e Andie MacDowell), në film nuk mungojnë skenat e shumta nudo: «Lakuriqësinë e përdora në një mënyrë tjetër», shpjegon regjisorja. “Kur Elisabeth është në banjë, ajo përballet me veten, shikon

veten dhe gjykon veten dhe shfaqet pa truke, e zhytur në realitet, ashtu siç është. Kur shohim Sue-n, trupi i saj shihet nga jashtë dhe për këtë arsye është i përshtatur në një mënyrë tjetër, sepse vlerësohet nga vështrimi i publikut: për këtë arsye i kërkova Margaret-it që të përgatitej sa më mirë me javë të vështira stërvitje në palestër, për të përfaqësuar këtë stereotip të hiperseksualizuar, në dukje të përsosur”.

Pastaj sigurisht që është dhuna dhe gjaku që rrjedh në lumenj dhe ndoshta nuk do ta prisnit nga një regjisore femër, nëse nuk do të ishte faktin që Fargeat kishte debutuar me *Revenge*, një thriller që i përket zhanrit gore, në të cilin një vajzë që është viktimë e përdhunimit hakmerret dhe kryen një masakër.

“Dhuna në filmin tim është ekstreme, sepse e shoh si një pasqyrim të asaj që zakonisht rezervohet për gratë në shoqëri, por për mua ajo bëhet edhe një mënyrë për t’u vetëshpallur. Në fakt, teksa rritesha, më dukej se si femër duhej të isha vetëm delikate dhe e ndjeshme dhe se filmat e zhanrit të caktuar si horror rezervoheshin vetëm për meshkujt, të cilët kishin shumë më tepër liri, ndërsa besoj se nuk duhet të kishte dallime”. / bota.al



# Thirrjet raciste ndërprejnë ndeshjen Rumani - Kosovë

## “Epoka e re”

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Në minutat shtesë është ndërprerë ndeshja në mes Rumanisë dhe Kosovës (0-0), ku fillimisht ndodhi një përplasje mes kapitenit Amir Rrahmani dhe rumunit Alibec, dhe me pas filluan thirrjet raciste “Serbia, Serbia”. Pas kësaj “dardanët” u tërhoqën nga fusha dhe refuzuan të rikthehen, derisa gjyqtari kryesor vendosi për përfundimin e ndeshjes. Kosova e dominoi nga fillimi e deri në momentin e ndërprerjes me lojë e raste kundërshtarit dhe vetëm goli mungojë për të kompletuar një paraqitje fantastike. Megjithatë



gjithkush duhet të respektojë faktin që ne jemi Kosova. “Para ndeshjes ju kam thënë futbollistëve të shfaqin se si Kosova mund të luajë futboll dhe e kemi bërë këtë gjë. Fatkeqësisht në minutat përfundimtar e humbi

fushë. Gjithkush duhet ta respektojë faktin që ne jemi Kosova”, ka thënë Foda. Në konferencë ishte prezent edhe kapiteni Amir Rrahmani, i cili ka thënë Kosova është Kosovë dhe kështu do të mbetet, derisa i bëri thirrje UEFA-s që të ndërmarrë masat e nevojshme. “Sonte ka pasur ofendime dhe thirrje racore gjatë tërë ndeshjes. Kemi kërkuar tri herë të marrin masa. Ne kemi shkuar në zhveshtore, situata është përkeqësuar edhe më shumë. Për këtë arsye kemi vendosur të mos kthehemi në fushë. Bëj thirrje UEFA-s dhe FIFA-s të ndërmarr masa e nevojshme. Vendi ynë ka një të kaluar të vështirë. Ka pas luftë, masakra dhe nuk ka qenë e lehtë të arrihet këtu. Kosova është Kosovë dhe kështu do të mbetet”, ka thënë Rrahmani. UEFA ka dalë me një njoftim të shkurtër për ndeshjen Rumani-Kosovë: “Ndeshja e Ligës së Kombeve në mes të Rumanisë dhe Kosovës është ndërprerë. UEFA do të dalë me informacione të mëtejme në kohën e duhur”.



dy minuta para fundit eskaloi situata pas provokimeve të vendasve dhe ndeshja përfundoi. Përzgjedhësi i Kosovës, Franco Foda në konferencë për medie pas gjithë kësaj situate, ka thënë se vendosën bashkërisht të mos kthehen në fushë, pasi

respektin dhe për këtë arsye vendosëm të largohemi nga fusha. Më pas kemi biseduar me të gjithë, edhe me trajnerin Lucescu për t’u kthyer në fushë. Por situata në stadium nuk ndryshoi dhe për këtë arsye vendosëm të gjithë së bashku të mos kthehemi në



## SHKURT

### ‘Dardanët’ vazhdojnë stërvitjet intensive

Kosova po vazhdon stërvitjet intensive për ndeshjet e nëntorit. “Dardanët” janë duke u stërvitur dy herë në ditë, që të jenë sa më të gatshëm për takimet e rëndësishme. Atmosfera në kampin dardan është shumë e mirë. Të gjithë basketbollistët po japin maksimumin, ndërsa përzgjedhësi Jean-Denys Choulet është shumë i kënaqur me angazhimin e tyre. Lista finale do të shpallet më 19 nëntor. Kujtojmë se Kosova do të përballet me Zvicrën më 21 nëntor në Bern dhe më 24 nëntor me Irlandën në Dublin. Ndeshjet zhvillohen në kuadër të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2027.

### Të shtunën një ndeshje në Superligën e hendbollit, të dielën tri

Pas ndeshjeve të Kombëtares dhe zhvillimit të disa ndeshjeve të shtyra, në fundjavë zhvillohet xhiroja e rregullt në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Të shtunën është një ndeshje, ndërsa të dielën tri të tjera. Të shtunën nga ora 19:00 në palestrën “Karagaçi” takohen Besa Famgas dhe Prishtina. Besa vlerësohet favorite, por Prishtina shpreson në befasi. Besa është e dyta me 12 pikë, përkatësisht me bilanc prej gjashtë fitoresh e dy humbjesh. Prishtina renditet e katërta me 10 pikë. Ka pesë fitore dhe tri humbje. Kampioni në fuqi, Rahoveci, llogaritet në dy pikë të reja kur të takohet me Vushtrrinë të dielën nga ora 18:00. Nga ora 14:00 takohen Llapi dhe Kastrioti, ndërsa ndeshja Vjosa - Trepça fillon në orën 18:00. Këtë fundjavë vazhdon gara edhe në Ligën e Parë. Në program është xhiroja e gjashtë. Të dielën prej orës 18:00 janë dy ndeshje: Deçani - Vëllaznimi, Prizreni - Drita. Ndeshja në mes të Drenicës dhe Istogut zhvillohet më vonë.

### Pesë lojtarë nderohen në ‘Air Albania’ para përballjes me Çekinë

Bekim Balaj dhe Odise Roshi iu shtuan listës së futbollistëve që u tërhoqën nga Kombëtarja. Pjesë e kësaj liste janë edhe Klaus Gjasula, Ermir Lenjani dhe Sokol Cikalleshi, të cilët e mbyllën aventurën me kuqezinjtë pas “Euro 2024”. Kontributi i tyre është i padiskutueshëm, ku paraqitjet dhe golat e shënuara kanë ndihmuar kuqezinjtë të shkojnë drejt arritjeve të mëdha. Për t’i nderuar veteranët e Kombëtares, FShF-ja ka menduar t’i surprizojë. Para startit të sfidës me Çekinë që do të luhet ditën e nesërme në “Air Albania” në orën 20:45 do të organizohet një ceremoni ku do të nderohen pesë ish-ët e skuadrës. Gjasula, Lenjani, Cikalleshi, Balaj dhe Roshi do t’i kenë mundësitë të zbresin edhe njëherë tjetër në “Air Albania” dhe t’i shijojnë emocionet e forta para tifozëve kuqezi për ta mbyllur kështu një cikël fantastik në Kombëtare.

## Nipi i Adem Jasharit ëndërron të luajë për Real Madridin

Futbollisti i FC Prishtina, njëherësh nipi i komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, Igbal Jashari, foli pas fitores 1-3 ndaj Maqedonisë së

Veriut. Pas ndeshjes, ai tha se u mundua të japë 100% nga vetja, teksa zbuloi një ëndërr. “Ndeshja shkoi mjaft mirë. Ne arritëm prej 1:0 ta bëjmë

rezultatit 3:1. Jemi mjaft të kënaqur me rezultatit. Në ndeshjen tjetër shpresojmë edhe më mirë. Unë u mundova të jap 100%, t’i ndihmoj ekipit

sepse të luash për kombëtaren është ndjenjë e veçantë. Synimet e mia janë të arrij të luaj në arenën ndërkombëtare. Klubi im i preferuar është Real

Madridi. E dua atë klub prej Cristiano Ronaldos dhe ëndërroj dhe shpresoj që një ditë të luaj për Real Madridin”, ka thënë Jashari për “Open TV”.

## Leclerc: Në Las Vegas rikthehem te fitorja

**LAS VEGAS, 15 NËNTOR** - Edhe këtë fundjavë botërori i Formulës 1 është pushim, për të nisur më pas një fund-sezon të zjarrtë, me tri gara radhazi. Te Ferrari, pas disa fitoresh radhazi, janë të bindur se fitimi i titullit kampion për konstruktorë

është i mundshëm, duke parë dallimin e vogël ndaj McLarenit në renditje. I bindur për këtë është piloti monogask Charles Leclerc, që në prag të garës në Las Vegas ka thënë: "Kjo është një pistë ku ne duhet të bëjmë mirë. Është fakt që

kemi përmirësuar shumë menaxhimin e gomave këtë vit. Duke qenë se të gjithë jemi shumë afër në luftën për fitore, besoj se do të kemi ende një shans për sukses". Më pas 27-vjeçari nga Montekarlo ka shtuar: "Sezoni është drejt fundit.

Janë tri gara të njëpasnjëshme, pa pushim dhe gjithçka mund të ndodhë. Nëse e nisim me një rezultat të mirë në Las Vegas, atëherë edhe motivimi për dy garat në Arabi do të jetë më i madh. Ky është objektivi ynë".



## Mourinho është i padëshiruar në Turqi

**STAMBOLL, 15 NËNTOR** - Kapitani i Galatasarayt, Fernando Muslera, i ka thënë trajnerit të Fenerbahçes, Jose Mourinho, të largohet nga Superliga e Turqisë pas komenteve dhe veprimeve të tij të diskutueshme në muajt e fundit.

Trajneri portugez është lidhur me një rikthim në Ligën Premierë javët e fundit dhe tani me skuadrën e tij pesë pikë prapa liderit Galatasarayt, ai mund të kërkojë një rol të ri.

Muslera beson se kjo do të ishte më e mira për futbollin turk dhe thotë se veprimet e Mourinhos kanë ofenduar shumë njerëz që duan që ai të largohet tërësisht nga liga. "Fyerjet ndaj futbollit turk dhe fakti që ai po sulmon disa gjyqtarë janë gjëra që më shqetësojnë mua", ka deklaruar Muslera për "Turkiye Today". "Kjo është hera e parë në 14 vjet që ndihem i detyruar të bëj një deklaratë të tillë. Kam fituar 17 trofe në 14 vjet. Nëse marrim



parasysh kontributin tim, synimi im i vazhdueshëm është të avancoj futbollin turk. Nëse Mourinho, i cili erdhi këtu 4 muaj më parë, kritikon futbollin turk dhe nuk i pëlqen, ai mund të largohet. Edhe pse askush nuk thotë asgjë, mendoj se tani dikush mund t'i thotë diçka. Duhet t'u kushtojmë pak më shumë vëmendje atyre që e çojnë futbollin turk përpara", ka shtuar ai.

Duke folur pas barazimit 1-1 të

skuadrës së tij të Fenerbahçes kundër ish-klubit Manchester United në Ligën e Evropës, Mourinho la të kuptohet se donte të largohej dhe kishte punë të papërfunduar në Premierë Ligë. "Gjëja më e mirë që duhet të bëj është që kur të largohem nga Feneri është të shkoj në një klub që nuk luan në kompeticionet e UEFA-s. Pra, një klub në fund të tabelës që ka nevojë për një trajner për dy vjet. Unë jam gati të shkoj", kishte thënë Mourinho.

## Icardi: Wanda Nara shtrembëron gjithçka për interesat e veta

**STAMBOLL, 15 NËNTOR** - Pak orë pas përhapjes së lajmit për denoncimin e Wanda Narës kundër ish-bashkëshortit të saj Mauro Icardi për dhunë të dyshuar, sulmuesi i Galatasarayt foli në programin "Socios delspect", duke shprehur këndvështrimin e tij mbi një çështje ende për t'u sqaruar: "E gjitha kjo është ekzagjerim nga Wanda, unë nuk kam përdorur asnjë lloj dhune. Ajo raporton gjithçka në media, e deformon gjithçka në favorin e vet. Edhe mediet e pasqyrojnë për interesat e veta personale. Më ekspozuat si idiot para të gjithëve kur publikuat mesazhin tim. Kjo është dhunë psikologjike". Sipas programit LAM të transmetuar në "America TV", showgirl argjentinase denoncoi ish-partnerin dhe babanë e dy vajzave të saj për keqtrajtim dhe vjedhje brenda familjes. Thuhet se Icardi,



aktualisht në Argjentinë për fazën e parë të rehabilitimit të dëmtimit të ligamentit të gjurit, nuk e kishte lejuar Wanda Narën të hynte në një nga apartamentet që zotërojnë së bashku. Për pasojë, tonet ishin ngritur deri në thirrjen e policisë dhe denoncimin përkatës për dhunë, shtoi këtu gjoja vjedhjen nga Icardi të 70 mijë dollarëve të saj. Çështja u mor

menjëherë në dorë nga Galatasaray, i cili lëshoi një deklaratë për këtë çështje, duke mbrojtur sulmuesin e vet: "Spekulimet për lojtarin tonë Mauro Icardi nuk pasqyrojnë të vërtetën. Sulmuesi po rikuperohet në shtëpinë e tij në Argjentinë. Kërkojmë nga të gjithë që të mos u kushtojnë vëmendje lajmeve të tilla, që synojnë t'i destabilizojnë sportistët tanë".

### SHKURT

#### Alonso do të largohet nga Leverkuseni në fund të sezonit

Trajneri Xabi Alonso me gjasë do të largohet nga Bayer Leverkuseni në fund të sezonit. Destinacioni i ardhshëm i trajnerit të njohur mbetet enigmë, me alternativat që janë të shumta. Një nga klubet e mundshme është Real Madridi, me "Los Blancos" që e shikon atë si pasuesin e Carlo Ancelottit. Xabi Alonso deri më tani numëron 107 në krye të kampionëve të Gjermanisë, ndërsa ekipi ka marrë mesatarisht 2.17 pikë për çdo ndeshje. Arritja më e madhe është dërgimi i "aspirinave" në majën e futbollit gjerman, pra fitimi i një titulli kampion.

#### Spalletti: Futbollistët u treguan luanë të vërtetë

Italisë i mjaftonte vetëm një pikë në përballjen me Belgjikën, por arriti të fitojë tri pikë në këtë ndeshje (1-0). Në këtë mënyrë italianët janë kualifikuar në çerekfinalin e Ligës së Kombeve. Trajneri Luciano Spalletti ka thënë se futbollistët e tij u treguan luanë të vërtetë. "Djemtë u treguan të zotë, luanë të vërtetë, ditën edhe të vuajnë, si në pjesën e dytë ku humbën disa topa më shumë sesa duhej. Treguan se jemi një skuadër e fortë", ka thënë Spalletti.

#### Brazili dhe Argjentina zhgënjëjnë sërish në kualifikueset e Botërorit

Brazili dhe Argjentina zhgënjëjnë në javën e 11-të të ndeshjeve kualifikuese të Amerikës së Jugut për Kupën e Botës 2026. "Seleção" barazoi 1-1 në Venezuelë. Raphinha kaloi në avantazh Brazilin, por vendasi barazuan shifrat me Segovian. Vinicius ka një mundësi të artë për të rikthyer skuadrën e tij në avantazh, por gabon nga pika e bardhë e penaltisë. Argjentina posi një humbje 2-1 në transfertë përballë Paraguajit. Lautaro Martinez kalon shumë shpejt miqtë në avantazh, por vendasi përmbysin gjithçka dhe fitojnë 2-1. Në 11 ndeshjesh të luajtura, Argjentina vazhdon të qëndrojë në vendin e parë në grup me 22 pikë, e ndjekur nga Kolumbia me 19 pikë dhe Brazili me 17 pikë.

#### Leao: Nuk jam lojtar perfekt, kritikam më motivojnë

Sulmuesi i Milanit, Rafael Leao nga grumbullimi i Portugalisë, foli për kritikam që ka marrë së fundmi për paraqitjet tek kuqezinjët. "Po kaloj sezone të shkëlqyera në Milano. Sezoni sapo ka filluar. Natyrisht që nuk jam lojtari perfekt, ka raste kur mund të bëj shumë më mirë. Jam shumë vetëkritik. Këto kritika nuk më tunden gjithsesi. Kam njerëz në Milano dhe në ekipin kombëtar që më ndihmojnë të rritem. Nga njëra anë, këto kritika më ndihmojnë, më motivojnë të rritem edhe më shumë në fushë", ka thënë Leao.

## Giovani Dos Santos nga krahasimi me Messin te biznesmen i naftës

Giovani dos Santos ishte një talent i madh në ekipin e të rinjve të Barcelonës, klub me të cilin nënshkroi kur ishte 12 vjeç dhe për të cilin debutoi në moshën 17-vjeçare, duke shënuar një gol kundër Aarhus. Pas një sezoni në Barcelonë, në

të cilin u krahasua me Ronaldinon dhe u quajt "Messi i ri", karriera e tij e çoi në Tottenham Hotspur, Ipswich Town, Racing Santander, Mallorca, Villarreal dhe Los Angeles Galaxy në Amerikë. Dos Santos ka nënshtetësi

meksikane, braziliane dhe spanjolle dhe ka luajtur 106 herë për Meksikën, me të cilën fitoi medaljen e artë në Lojërat Olimpike 2012. Ai i vari çizmet e tij tre vjet më parë, dhe tani Dos Santos është jashtëzakonisht i suksesshëm

në botën e biznesit. Mediumi "Claro Sports" ka bërë të ditur se Dos Santos është bërë partner në kompaninë Procura Mexico, e lidhur ndryshe me kompaninë petrokimike Petroleos Mexicanos (PEMEX). "Informacionet tregojnë se

puna e re do t'i sjellë atij në mes 400,000 dhe 500,000 dollarë në vit", raportoi Abraham Bencid i Fox Sports. Në Meksikë, ata pretendojnë se Dos Santos drejton edhe biznesin e blerjes dhe shitjes së makinave luksoze në këtë vend.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Eko-Vasic" SH.P.K. me seli në Gjilan, si dhe me pronar Zvonimir Vasic, Draza Vasic, Stevan Vasic ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811181809 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Eko-Vasic" D.O.O. Gnjilane, sa vllasnikom Zvonimir Vasic, Draza Vasic, Stevan Vasic donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811181809 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all customers that the limited liability "Eko-Vasic" L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Zvonimir Vasic, Draza Vasic, Stevan Vasic has come to the decision to quit its business: 811181809 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS  
TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Shpat Arllati nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10. 11. 12 testin e maturës si dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Albulena Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Anita Stuja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit, dëftesat e kl. 10.11.12 dhe certifikatën e maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Faton Kastrati Vermicë, K.K Malishevë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. dhe diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Shqipe Goranci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Haxhi Ukshini nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Kushtrim Halili, shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.l.e. "Hasan Prishtina".

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





# TRADITË QË NGA

# 1992

